



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

Nr. 59/3 prot.

Tiranë, më 07.07.2020

N J O F T I M

PËR

**MARRJE ME QIRA TË PASURISË SË TË TRETËVE PËR USHTRIMIN E
AKTIVITETIT TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
(AIDA)**

1. Institucioni qiramarrës:

“Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Adresa: Blv.”Dëshmorët e Kombit”, Kryeministria, Kati III, Tiranë,

E-mail: sokol.nano@aida.gov.al;

2. Objekti i qirasë: *"Marrje me qira të pasurisë së të tretëve për ushtrimin e aktivitetit të Agjencisë Shqiptare Të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)"*

3. Përshkrim i pasurisë së të tretëve që kërkohet me qira:

- Të jetë objekt ndërtimor me sipërfaqe minimale të brendshme, rreth 450 m², e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit;
- Objekti të ketë hyrje të veçantë për punonjësit;
- Objekti të jetë i hipotekuar;
- Në objekt të jetë i siguar furnizimi pa ndërprerje me energji elektrike;
- Në objekt të jetë i siguar furnizimi pa ndërprerje me ujë;
- Gjenerator për të siguar energji elektrike 24 orë, (e domosdoshme për funksionimin e serverave dhe pajisjeve);

- Të ketë të instaluar dhe funksional sistemin e kondicionimit Ngruhje/Ftohje në të gjithë hapësirën dhe të përfshijë mirëmbajtjen e pajisjeve për gjithë periudhën e qirasë;
 - Ambienti të ketë tualete, jo më pak se 3 bokse, të pajisur me të gjitha hidrosanitaret dhe bolier;
 - Të jetë i pajisur me ashensor, kur nuk është kati i parë teknik;
 - Ambienti parapëlqehet të ndodhet në një perimetër sa më pranë Kryeministrisë.
 - Objekti duhet të respektojë përcaktimet e bëra nga Kodi i Punës i RSH si dhe aktet nënligjore të marra në dhe për zbatim të tij, lidhur me
 - përshtatjen e vendit të punës në të gjitha pjesët përbërëse me natyrën e aktivitetit që do të kryhet aty;
 - kushtet minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;
 - qëndrueshmërinë dhe pastërtinë (që muret, dyshemeja, tavanet duhet të jenë të fortë dhe në gjendje të mirë);
 - masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit të punës nga ndotja e ajrit, lëndët kimike, radioaktiviteti, zhurmat dhe dridhjet, si dhe çdo element të ngjashëm që është i dëmshëm për jetën dhe shëndetin e punonjësve.
4. Kohëzgjatja e kontratës së qirasë 3 (tre) vjet, me të drejtë rinovimi.
 5. Informacion mbi dokumentet e procedurës së qirasë: Dokumentet për zhvillimin e procedurës së qirasë janë të publikuara në faqen zyrtare të AIDA-s. www.aida.gov.al, ose mund të tërhiqen pranë zyrave të AIDA-s.
 6. Afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave: data **10.07.2020, ora 10.00.**
 7. Vendi i zhvillimit të procedurës konkurruese:

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)
Adresa: Blv."Dëshmorët e Kombit", Kryeministria, Kati III, Tiranë,
 8. Oferta dorëzohet nga të interesuarit në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin dhe afatin e përcaktuar.